

V E N D I M
Nr.59, datë 2.2.2001

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.364, DATË 14.7.2000, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË SHKURTOHEN NGA ZBATIMI I
MARRËVESHJES SË KONCESIONIT PËR UZINËN E FERROKROMIT, ELBASAN DHE
MINIERAT E KROMIT, PËRRENJAS DHE POJSKË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 6 të ligjit nr.8562, datë 22.12.1999, “Për përcaktimin e formës dhe strukturës së formulës së privatizimit të shoqërisë anonime, “Albkrom”, dhe të nenit 9 të ligjit nr.8590, datë 23.3.2000, “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOT”, për Uzinën e Ferrokromit, Elbasan, dhe minierat e kromit Përrenjas e Pojskë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe shoqërisë italiane, Darfo, S.p.A., dhënien e disa stimuljeve dhe garancive për koncesionarin e kësaj marrëveshjeje”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.364, datë 14.7.2000 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si vijon:

“2. Fondet financiare, prej 129 milionë lekësh, të nevojshme për shpërblimin e 398 punonjësve të Uzinës së Ferrokromit, Elbasan, të minierave të kromit, Përrenjas dhe Pojskë, dhe të administratës së “Albkrom”, sh.a., që kanë mbuluar këto njësi e që do të trajtohen sipas këtij vendimi, të përballohen nga Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit.

a) Për vitin 2000, shumën 64.5 milionë lekë, me fondet e dhëna nga koncesionari dhe nga fitimi i “Taulantia”, sh.a, të vitit 2000, në shumën 36.3 milionë lekë.

b) Për vitin 2001 shumën 64.5 milionë lekë, nga fondet e dhëna nga koncesionari, 200 000 USD, dhe diferenca nga fondet e krijuara, në zbatim të vendimit nr.416, datë 9.7.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për administrimin dhe përdorimin e të ardhurave të Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, nga privatizimi i shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë.”.

2. Pika 3 ndryshohet si vijon:

“3. Përfitojnë nga ky vendim punonjësit e Uzinës së Ferrokromit, Elbasan, të minierave të kromit, Përrenjas dhe Pojskë, dhe të administratës së “Albkrom”, sh.a., që kanë mbuluar këto njësi, të cilët kanë qenë të punësuar pranë tyre, pa ndërprerje, që nga 1.6.1999 e deri më datën 19.7.2000, data e hyrjes në fuqi e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta